



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
SEKRETARIATI**

Njoftim për Shtyp

(datë 27 Qershor 2007)

Mbi kërkesën për autorizimin e njoftimit të përqëndrimit të shitblerjes së 76 % të aksioneve të shoqërisë Albtelekom sh.a

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur një kërkesë nga ana e Çalik Enerji Telekomunikasyon Hizmetleri A.S.("CETEL") për marrjen e autorizimit të përqëndrimit për transaksionin e shitblerjes së 76 për qind të aksioneve të Albtelecom sh.a.

Më datë 19 qershor 2007, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërisë Albtelecom sh.a, i shiti CETEL paketën prej 11 400 000 aksione me vlerë nominale prej 1 000 lekë aksioni, që përfaqësojnë 76 % të kapitalit të Albtelecom që përfaqëson shumicën e të drejtave të votës në Asamblenë e Përgjithshme.

Si rrjedhim, CETEL përfiton në mënyrë direkte kontrollin ekskluziv(të plotë) të Albtelecom dhe në mënyrë indirekte të "Eagle Mobile" sipas nenit 10, pika 1 shkronja b të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës".

Autoriteti i Konkurrencës do ta shqyrtojë përqëndrimin CETEL-Albtelecom mbështetur në nenin 10, 12, nenet për procedurat e kontrollit të përqëndrimeve(53-64), të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës".

Autoriteti i Konkurrencës është i interesuar të dijë opinionin dhe do të marrë në konsideratë çdo koment për këtë kërkesë.

Komentet me shkrim mund të adresohen në adresën:

Autoriteti i Konkurrencës
Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut
Rruga "Sami Frashëri", nr.4, kati IV
Tiranë, Shqipëri
www.caa.gov.al
competition@caa.gov.al